



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **16.9.2024**, me fillim në orën **11:35**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje nënkryetar **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **nëntë (9)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Rishqyrtimi i vendimit 01 Nr.235/24, i datës 25.7.2024, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510026-00041-1 ZK-Drenoc;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2025;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush nuk ka ndonjë gjë, vazhdojmë me pikën e parë.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë diskutim rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Konstatoj që me shumicë votash (5 vota “për”) votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Rishqyrtimi i vendimit 01 Nr.235/24, i datës 25.7.2024, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510026-00041-1 ZK-Drenoc:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për anëtarët e KPF-së! Para jush keni vendimin i cili duhet të rishqyrtohet, për shkak të pikës së 1-rë të vendimit. Pika e 1-rë e vendimit thotë: Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr.235/24, i datës 27.07.2024, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik. Pika e 2-të thotë: Pika 1 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim: Me këtë vendim shpallet me interes të përgjithshëm publik ndërtesa administrative në sipërfaqe 200m², e evidentuar në emër të KB “Bujku”, Drenoc, Rahovec, ndërtesat gjenden në parcelën me nr. 00041-1.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse dikush ka diçka për të thënë?... Nëse jo, po e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Atëherë, unanimisht 5 vota “për” votohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2025:

Afrim Limani: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për anëtarët e KPF-së! Pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë, me biznese, me shoqërinë civile, me fermerë, erdhi koha që të shqyrtohet propozim-vendimi për miratimin e buxhetit për vitin 2025 dhe projeksionet 2025-2027. Në seancën e këtij shtatorit pritet të miratohet nga anëtarët e Kuvendit. Në buxhetin për vitin 2025, janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i projekteve të rëndësishme për Komunën e Rahovecit, kërkesa dhe propozime të bëra nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore, që janë mbajtur në qytet dhe në disa vendbanime. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2025, duke i përfshirë të gjitha kategoritë ekonomike, në total është 20,982,796.00€.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për nënkryetarin dhe për anëtarët e KPF-së! Për vitin 2023, janë të parapara 750.000€ për projektin e sheshit, i cili për tri vjet do të kushtojë rreth 4 milionë €. Sa para janë paguar deri më tani?

Afrim Limani: Faleminderit për pyetjen, Defrim! Po, sheshi qendror do të kushtojë rreth 4 milion € dhe deri më tani janë paguar 1.700.000€.

Burim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje nënkryetar, anëtarë të KPF-së! Në buxhetin për vitin 2025 janë rreth 5 milionë € projekte të reja. A ekziston mundësia që përsëri të kemi probleme përmbartimore nëse do të ketë vonesa në kryerjen e obligimeve? Në seancën e rregullt, nëse ka mundësi ta kemi listën e projekteve me përmbajtje, që do të financohen në vitin 2025. Gjithashtu, ta kemi një listë të kërkesave të qytetarëve që janë involvuar në buxhetin e vitit 2025.

Afrim Limani: Po, Burim, do ta kemi një listë ashtu sipas kërkesës që e bëre. Ka shumë kërkesa të qytetarëve që janë futur në buxhet. Lista e kërkesave ka dalë nga dëgjimet buxhetore që janë mbajtur, gjithsej 14 dëgjime buxhetore. Do t'i përgatisim dhe do t'ju sjellim në seancën e shtatorit.

4. Të ndryshme:

Kryesuesi: Faleminderit për kontributin! Atëherë, jemi te pika e fundit, te të ndryshme, nëse dikush ka diçka për të shtuar? Nëse jo, atëherë me kaq po e përfundojmë mbledhjen e nëntë të KPF-së. Shihemi në seancën e rregullt të Kuvendit.

P.s.: Gjatë mbledhjes, ka pasur probleme teknike me incizim, procesverbali nuk është regjistruar fare si audio. I tëri është shkruar me dorë.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

